

Në përputhje me nenin 6 të ligjit “Për armët” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/2005, 47/2006 dhe 42/2007), Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

RREGULLOREN PËR LLOJET E ARMËVE QË MUND TË BLIHEN NË BAZË TË AUTORIZIMIT TË LËSHUAR DHE KUPTIMI I DISA LLOJEVE TË ARMËVE TË KATEGORIVE A DHE D

Neni 1

Kjo Rregullore përcakton llojin e armëve që mund të blihen në bazë të autorizimit të lëshuar dhe kuptimin e disa llojeve të armëve të kategorive A dhe D, në përputhje me kategorizimin e armëve të përmendur në nenin 4 të ligjit “Për armët” (në vijim referuar si: kategorizimi ligjor i armëve).

Neni 2

Në bazë të autorizimit të lëshuar mund të blihen llojet e mëposhtme të armëve të kategorisë B:

1) revolver, pistoletë gjysmautomatike ose me përsëritje nga lloji i armëve të zjarrit gjysmautomatike ose me përsëritje;

2) pistoletë nga lloji i armëve të zjarrit me një qitje, me shkrepje qendrore;

3) pistoletë me shkrepje anësore me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28 centimetra dhe pistoletë me kalibër të vogël 22LR nga lloji i armëve të zjarrit me një qitje, me shkrepje anësore me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28 centimetra

4) pushkë gjysmautomatike me tytë të vjaskuar, me krehër dhe fole që mund të pranojnë më shumë se tre fishekë dhe pushkë gjysmautomatike me tytë të pavjaskuar, me krehër dhe fole që mund të pranojnë më shumë se tre fishekë nga lloji i armëve të zjarrit të gjata gjysmautomatike, me krehër dhe fole për fishekët që mund të pranojnë më shumë se tre fishekë;

5) pushkë gjysmautomatike me tytë të vjaskuar dhe pushkë gjysmautomatike me tytë të pavjaskuar nga lloji i armëve të zjarrit të gjata gjysmautomatike, me krehër dhe fole për fishekët, që mund të pranojnë deri në tre fishekë dhe që mbushësin e kanë të pafiksuar, d.m.th. një armë që mund të rindërtohet me ndihmën e veglave të zakonshme në mënyrë të atillë që krehri dhe foleja të pranojnë më shumë se tre fishekë;

6) pushkë me përsëritje me gjatësi të përgjithshme deri në 60 centimetra, me tytë me gjatësi të kombinuar, pushkë me përsëritje me tytë të vjaskuar me gjatësi deri në 60 centimetra, pushkë me përsëritje me tytë të pavjaskuar me gjatësi deri në 60 centimetra dhe pushkë gjysmautomatike me tytë të pavjaskuar me gjatësi deri në 60 centimetra nga lloji i armëve të zjarrit të gjata gjysmautomatike me përsëritje, me tytë të pavjaskuar me gjatësi deri në 60 centimetra dhe

7) pushkë gjysmautomatike me tytë të vjaskuar për përdorim civil, të cilat ngjasojnë me armët e zjarrit automatike, pushkë gjysmautomatike me tytë të pavjaskuar për përdorim civil, të cilat ngjasojnë me armët e zjarrit automatike dhe pushkë gjysmautomatike me tytë të kombinuar (të vjaskuara dhe të pavjaskuara) për përdorim civil, të cilat ngjasojnë me armët e zjarrit automatike nga lloji i armëve të zjarrit të gjata gjysmautomatike, për përdorim civil që ngjasojnë me armët e zjarrit automatike.

Neni 3

Në bazë të autorizimit të lëshuar mund të blihen llojet e mëposhtme të armëve të kategorisë C:

1) Pushkë me tytë të vjaskuar-karabinë, pushkë me tytë të pavjaskuar-pushkë gjahu dhe armë me tytë të kombinuar (të vjaskuara dhe të pavjaskuara) nga armët e zjarrit të gjata me

përsëritje që nuk janë përfshirë në pikën 6 të kategorisë B;

2) pushkë (karabinë) nga lloji i armëve të zjarrit të gjata me një qitje, me tytë të vjaskuar;

3) pushkë gjysmautematike me tytë të vjaskuar-karabinë dhe pushkë gjysmautematike me tytë të pavjaskuar – armë gjahu nga lloji i armëve të zjarrit gjysmautematike të gjata, që nuk janë përfshirë në pikat 4,5,6 dhe 7 të kategorisë B;

4) pistoletë me shkrepje anësore ose pistoletë me gjatësi më të madhe ose të barabartë me 28 centimetra dhe revolver me shkrepje anësore ose me gjatësi të përgjithshme më të madhe ose të barabartë me 28 centimetra nga lloji i armëve të zjarrit të shkurtra me një qitje, me shkrepje anësore, me gjatësi të përgjithshme më të madhe ose të barabartë me 28 centimetra dhe

5) pushkë gjahu nga lloji i armëve të zjarrit të gjata për një qitje me tytë të pavjaskuar.

Neni 4

Armë zjarri gjysmautematike e kategorisë A, pika 2 e kategorizimit ligjor të armëve dhe sipas kuptimit të kësaj Rregulloreje, konsiderohet:

- pistoletat automatike;
- pushkat automatike;
- pushkat automatike me tytë të vjaskuar;
- pushkat automatike me tytë të pavjaskuar;
- mitralozi dhe
- të tjera.

Pajisje të posaçme për armët e zjarrit të kategorisë A, pika 10 të kategorizimit ligjor të armëve dhe sipas kuptimit të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:

- silenciatorët;
- tytë me vidhosje të jashtme mbi pjesën e tyre të përparme ose zgjatime të tjera që përdoren vetëm për montimin e silenciatorëve;
- shënjestra optike që mund të montohet mbi armë, me zmadhim elektronik të dritës ose rrezeve infra të kuqe;
- pajisja për fshehjen e flakës së krijuar nga qitja;
- doreza rezervë e armës;
- kapaku që mbyll tërësisht tytën e armës dhe
- matësi i largësisë me rreze laser i integruar në shënjestrën e armës.

Neni 5

Armë pneumatike e kategorisë D, pika 1 e kategorizimit ligjor të armëve dhe sipas kuptimit të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:

- pistoletat pneumatike dhe
- pushkët pneumatike

Armë me hark e kategorisë D, pika 2 e kategorizimit ligjor të armëve dhe sipas kuptimit të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:

- harqet dhe
- balestrat.

Neni 6

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë pas shpalljes në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Numër 13.1-26747/1

18 prill 2007

Shkup

Ministre

e Punëve të Brendshme,

MA Gordana Jankuloska, nënshkrimi